

ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË SHEKULLIT 21 NË LËNDËN E MATEMATIKËS

(KLASAT 1-5, 6-9)

Tipi i programit: Themelor

Hyrje:

Kursi “Zhvillimi i Shkathtësive të Shekullit 21 në lëndën e Matematikës” është zhvilluar nga KEC, në kuadër të Programit për Arsimin Themelor, i financuar nga USAID, për të ndihmuar arsimin kosovar në zhvillimin e shkathtësive relevante të shekullit 21 tek nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Kursi është hartuar nga një ekip i përbërë nga konsulentë vendorë dhe ndërkombëtarë në fushën e matematikës.

Pasi është akredituar në vitin 2013, kursi u është ofruar 1640 mësimdhënësve, si dhe janë krijuar 185 fasilitatorë shkollorë përmes të cilëve është ofruar ky kurs. Këta mësimdhënës dhe fasilitatorë kanë pasur rast të japin sugjerimet/rekomandimet për përmirësimin e aspekteve të caktuara të kursit.

Qëllimet e kursit:

- Të kuptuarit e matematikës si shkencë e modeleve dhe e raporteve dhe si një shkencë që zbatohet në situata të ndryshme në jetën e përditshme
- Ngritja e vetëdijes për qasjet, burimet dhe teknologjitë e reja në mësimdhënien e matematikës,
- Paraqitja e rolit të hulumtimeve matematikore në zhvillimin e shkathtësive të shek. XXI siç janë: zgjidhja e problemeve, puna ekipore, të menduarit kritik dhe TIK-u në mesin e nxënësve tuaj,
- Ofrimi i ideve praktike për t’u përdorur në orët e matematikës,
- Përmirësimi i arritjeve të nxënësve në matematikë.

Rezultatet e të nxënit

Pas përfundimit të kursit, vijuesit janë në gjendje të:

- Kuptojnë procesin e hulumtimit në matematikë
- Kuptojnë strategjitë sipas Polyas për zgjidhjen e problemeve
- Kuptojnë për hulumtimet e reja në lidhje me zhvillimin e fëmijëve dhe zhvillimin e trurit
- Organizojnë aktivitete në klasë për të zgjeruar të kuptuarit e numrit tek nxënësit.
- Organizojnë probleme praktike në klasat e tyre.
- Shpjegojnë konceptet matematikore nëpërmjet shembujve konkretë nga përditshmëria jonë
- Mësojnë disa lojëra që mund të ndërlidhen me njësitë përkatëse nga matematika
- Njihen me punën e kalkulatorit dhe programeve kompjuterike (Geogebra, Excel, Logo)

- Njihen me disa burime të rëndësishme në internet.
- Kërkojnë, përmes makinave të kërkimit, për burime të tjera të informacionit, e që lidhen drejtpërdrejtë me punën e tyre të përditshme në shkollë.

Implementimi i kursit (metoda, forma, dhe vendi):

Kursi “Zhvillimi i Shkathtësive të Shekullit 21 në lëndën e Matematikës” do të realizohet në dy faza:

1. Kursi treditësh (18 orë)

Në këtë rast, kursi do të mbahet nga fasilitues shkollorë të aftësuar dhe certifikuar nga KEC. Secila nga tri ditët e kursit ka nga katër sesione pune 90 minutëshe.

Gjatë kësaj faze fasilituesit shkollorë do të jenë të përkrahur nga kryefasilituesit përkatës të certifikuar nga KEC.

2. Zbatim i njohurive të reja me nxënësit në klasë të fituara nga kursi (6 orë)

Pas përfundimit të ditës së dytë të kursit treditësh, në dy javët në vijim mësimdhënësi fillon të zbatojë përmbajtjen e kursit me nxënësit në klasë për të zhvilluar shkathtësitë relevante të tyre. Dy ditët e para mbahen radhazi. Pas ditës së dytë, mësimdhënësit do të inkurajohen të organizojnë aktivitete me nxënësit në klasë. Të gjitha aktivitetet duhet të jenë në përputhje të plotë me konceptin dhe planin e programin e lëndës, me qëllimet e kurrikulës kombëtare, dhe me shkathtësitë relevante për shekullin 21. Ndërsa dita e tretë realizohet pas së paku dy javësh, kur mësimdhënësit sjellin përvojat e tyre nga puna me nxënësit në klasë, dhe planifikojnë dinamikën e punës deri te përmbushja e kriterëve për certifikim.

Në ditën e tretë të kursit, mësimdhënësit sjellin përvojat e tyre nga puna me nxënësit në klasë, dhe planifikojnë dinamikën e punës deri te përmbushja e kriterëve për certifikim. Vijuesit e kursit e kursit do të jenë mësuesit e ciklit fillor dhe arsimtarët e shkollave të mesme të ulëta nga lënda e matematikës, të përkrahur nga fasilitatorët shkollorë dhe drejtori/ja i/e shkollës. Këta mësimdhënës duhet të kenë njohuri të mira të matematikës në përgjithësi.

Materialet dhe pajisjet arsimore

Të gjitha shkollat, mësimdhënësit e të cilave marrin pjesë në këtë kurs, pajisen me udhëzuesit për realizimin e këtij kursi, si dhe secila shkollë e përfshirë në proces do të pajiset me pakon arsimore për matematikë, e cila përfshin mjete praktike për konkretizimin e mësimdhënies së matematikës në klasë. Gradualisht, shkollat dhe komunat do të inkurajohen për të marrë pjesë në sigurimin e kushteve për implementimin e kursit.

Vlera e aktiviteteve të kursit e shprehur në orë për licencim dhe certifikim

Programi ka gjithsej 24 orë, ndërsa kushtet për certifikimin janë:

1. Pjesëmarrja me rregull në kurs, së paku 90% të kohëzgjatjes së kursit
2. Zbatimi i së paku pesë (5) njësive mësimore sipas metodologjisë së kursit, i dokumentuar përmes dosjes së zhvillimit profesional.
3. Shikimi i dosjes së zhvillimit profesional nga fasilitatori/ja dhe drejtori dhe rekomandimi i tyre për përmbushjen e kriterëve për certifikim.